



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

Ballsh, më _____._____.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Mbikqyrje Punimesh në objektin Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjecare “Ismail Klosi” Ballsh”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 71521000-6 - Shërbime për mbikqyrje të ndërtimit.

Vlera e fondit limit:

1.812.993,24 (një milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre presje njëzetë e katër) lekë pa TVSH.

Bazuar në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër, për nevoja të saj.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhërin përkatës të prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesës (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të përshtatshmërisë për të kryer veprimtarinë profesionale ka për qëllim garantimin që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik janë të ligjshëm, të aftë dhe të besueshëm për realizimin e kontratës. Nëpërmjet këtij vetëdeklarimi, operatori ekonomik konfirmon ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me objektin e kontratës, disponimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale dhe ligjore, si dhe mungesën e shkaqeve të përjashtimit. Kjo kërkesë lehtëson procesin e vlerësimit, rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë e ofertuesve dhe kontribuon në sigurimin e konkurrencës së ndershme dhe mbrojtjen e interesit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1, 2/b dhe 3,

të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2025 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësi/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke

përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit , nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23 .12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenit 55 pika 4, germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme për mbikqyrje të punimeve objekt i kontrates, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për kategoritë si më poshtë ose ekuivalente të tyre:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P - 1 Punime germimi në tokë;
- N.P - 2 Ndërtime civile dhe industriale;
- N.P - 3 Rikonstrukcion dhe mirmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje

- fasadash
- N.P – 7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
- NP – 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S –1 Punime për prishjen e ndertimeve
- N.S –2 Impiante hidro-sanitare,kuzhina, lavanteri,mirmbajtje e tyre
- N.S - 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
- N.S – 12 Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- N.S – 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- N.S – 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- N.S – 18 Punime topogjodezike.

Licencat duhet te jete lëshuar sipas rregullave te VKM nr.759 date 12.11.2014 ‘‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar me VKM nr. 943 date 28.12.2016. Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licencat e mësipërme kërkohen në bazë të zërthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve, në zbatim të VKM, Nr. 42, Datë 16.1.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Sipas lidhjes Nr.2 dhe lidhjes Nr.4.

Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimore të përgjithshme dhe speciale, të cilat kërkojnë: ndërhyrje në strukturë dhe në elementë mbajtës; punime infrastrukturore instalime teknologjike, elektrike, termike dhe telekomunikimi; punime rifiniture dhe specializime të ndryshme teknike. Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licenca profesionale përkatëse, konkretisht:

Licencat N.P. sigurojnë aftësinë teknike për realizimin e punimeve të përgjithshme ndërtimore, gërmimeve, rikonstruksioneve, si dhe veprave infrastrukturore dhe energjetike;

Licencat N.S. garantojnë kapacitetin profesional për kryerjen e punimeve speciale, si: prishje dhe ndërhyrje të kontrolluara; instalime hidro-sanitare, termike dhe të kondicionimit; instalime elektrike, telefonike; punime metalike, betonarme; punime topogjeodezike të domosdoshme për saktësinë e zbatimit.

Vendosja e licencave të mesiperme është ne perputhje të natyrës dhe kompleksitetit të punimeve. Mbështeten në legjislacionin në fuqi, janë proporcionale dhe jo diskriminuese, pasi kërkohen vetëm licenca që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listë të personelit kryesor (drejtues teknik), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj, si dhe CV-në e tyre, diplomat, kontratë individuale pune të noterizuar dhe licencën personale të mbikqyrjes të tyre. Drejtuesit teknike të kërkuar më poshtë duhet të figurojnë në listepagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për muajin e fundit nga dita e hapjes së tenderit (formularët E-ig025/a.1):

• Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
• Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
• Inxhinier Elektronike	1 (një)
• Inxhinier Elektrike	1 (një)
• Inxhinier Gjeodet	1 (një)
• Inxhinier Mekanike	1 (një)
• Arkitekt	1 (një)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhën muajin e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë minimalisht 7 (shtatë) persona për periudhën muajin e fundit e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë e punonjësve të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që

ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri minimal i personelit është përcaktuar mbi bazën e : zerave te preventivit dhe volumit të punimeve që do të mbikëqyrjen, kohëzgjatjes së kontratës, nevojës për kombinim të stafit inxhinierik dhe mbështetës, kërkesës për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Vërtetimi i këtij kriteri përmes: vërtetimit nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku evidentohet numri i punonjësve për secilin muaj, dhe listë-pagesave sipas formatit ligjor, siguron që personeli: është i deklaruar ligjërisht, ka një marrëdhënie reale pune me operatorin ekonomik, nuk është personel i angazhuar fiktiv apo i përkohshëm vetëm për qëllime kualifikimi. Nga ana teknike dhe profesionale, disponueshmëria e këtij numri punonjësish tregon se operatori ekonomik: ka strukturë të qëndrueshme organizative, zotëron kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar ngarkesën teknike të kontratës, minimizon rrezikun e vonësive, mungesës së mbikëqyrjes ose cilësisë së dobët të shërbimit. Në këtë numër total punonjësish përfshihet si: stafi inxhinierik i kërkuar sipas licencave, i cili siguron mbikëqyrjen profesionale dhe teknike, ashtu edhe stafi mbështetës, i domosdoshëm për funksionimin administrativ, dokumentimin, raportimin dhe ndjekjen e kontratës.

Si përfundim, ky kriter është proporcional, i justifikuar teknikisht dhe i domosdoshëm, duke garantuar që kontrata të realizohet nga operatorë ekonomikë me kapacitet real dhe të provuar për përmbushjen e objektit të prokurimit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2023.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi : Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme të sistemeve të menaxhimit, ka për qëllim të sigurojë që shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të realizohet në përputhje me standardet profesionale, teknike dhe organizative, duke garantuar cilësi, siguri dhe efikasitet gjatë gjithë ciklit të zbatimit të kontratës.

a) Certifikata ISO 9001:2015 garanton që operatori ekonomik disponon: procedura të standardizuara për menaxhimin e shërbimit, mekanizma të kontrollit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, strukturë organizative që siguron gjurmueshmëri, korrektësi dhe transparencë në mbikëqyrjen teknike.

b) Certifikata ISO 45001:2023 garanton që operatori ekonomik: ka identifikuar dhe vlerësuar rreziqet në vendin e punës, zbaton procedura për parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve, siguron trajnime dhe masa mbrojtëse për personelin e angazhuar në terren.

c) Certifikata ISO 50001:2018 garanton që operatori ekonomik: disponon procedura për monitorimin dhe optimizimin e përdorimit të energjisë, siguron zbatim korrekt të zgjidhjeve teknike energjetike gjatë punimeve, kontribuon në reduktimin e humbjeve energjetike dhe kostove afatgjata të objektit publik.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave ISO 9001:2015, ISO 45001:2023 dhe ISO 50001:2018 është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, garanton cilësi, siguri dhe eficiencë në zbatimin e kontratës, nuk është diskriminuese, pasi pranon certifikata ekuivalente të akredituara është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Shënim : Operatorët ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohen Rekomandimit të APP-se Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale” të specifikuara në VKM Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, e cila duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes : Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike/preventivi/dokumentacioni i nevojshëm, është i njëjtë me ato të objektit të kontratës : Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjecare Ismail Klosi Ballsh

si dhe në përputhje me nenin 4,pika 7,38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Afati i Ekzekutimit: 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT